



Pyetje dhe përgjigje për vaksinimin

Përse duhet të vaksinohem kundër koronavirusit SARS-CoV-2?

COVID-19 është një sëmundje e rëndë, e cila mund të çojë në infeksione të rënda ose deri në humbjen e jetës. Disa paciente dhe pacientë vazhdojnë të vuajnë për kohë të gjatë edhe pas infektimit, me simptoma të tilla si lodhja, marrja e frymës apo humbja e nuhatjes dhe e shijimit (COVID afatgjatë). Kush sëmuret me COVID-19, mundet që të infektojë miqtë, kolegët dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, edhe pa e ditur. Mbrojtja më e mirë kundër infektimit nga COVID është vaksinimi. Kush vaksinohet mbron veten e tij dhe jep një kontribut të çmueshëm në luftën e përbashkët kundër koronavirusit.

A është e mundur që në verë të ofrohet mundësia e vaksinimit për të gjithë qytetarët dhe qytetaret në Gjermani?

Po. Nga muaji qershor, çdo person që dëshiron mund të kërkojë planifikimin e një date për vaksinimin, pavarësisht nga mosha, sëmundjet e mëparshme ose profesioni që bën. Sipas të dhënave që disponojmë aktualisht, është e mundur që gjatë verës të bëhet një ofertë për vaksinimin për këdo në Gjermani.

A është i detyrueshëm vaksinimi?

Jo. Vaksinimi është me zgjedhje të lirë. Por vaksinimi është mbrojtja më e mirë kundër koronavirusit. Nëpërmjet vaksinimit ju jepni gjithashtu një kontribut të çmueshëm në luftën e përgjithshme kundër virusit.

Sa e sigurt është vakcina kundër COVID-19?

Të gjitha vaksinat e miratuara në Evropë nga Agjencia Evropiane e Barnave EMA janë të sigurta dhe efektive. Përpara miratimit të tyre janë zhvilluar studime të gjera lidhur me tolerueshmërinë, sigurinë dhe efektivitetin e tyre.

Çfarë efektesh të padëshirueshme mund të shfaqen pas vaksinimit?

Ashtu si me çdo vaksinë tjetër, edhe pas vaksinimit kundër COVID-19 mund të shfaqen reagime nga vakcina dhe efekte të padëshirueshme. Zakonisht këto shfaqen pak kohë pas vaksinimit dhe zgjatin për pak ditë. Ajo çfarë ndodh më së shumti është dhimbja në vendin e shpimit në krah. Shumë njerëz pas një vaksinimi ndihen të lodhur, kanë dhimbje koke ose temperaturë të lehtë.

Kur mund të planifikoj një datë për vaksinimin tim?

Në datën 7 qershor përfundon afati i përcaktimit të prioritetit të personave për vaksinim, kështu që pas kësaj date vaksinimi është i mundur për këdo, pavarësisht nga mosha, sëmundjet e mëparshme ose profesioni që bën. Ju mund të përcaktoni një datë nëpërmjet mjekut të familjes ose klinikës mjekësore të specialiteteve. Gjithashtu është e mundur, sipas rastit, që vaksinimi të bëhet edhe nga mjeku i ndërmarrjes në vendin tuaj të punës. Caktimi i datës së vaksinimit varet nga disponueshmëria e sasisë së vaksinave.

A duhet të paguaj diçka për vaksinimin?

Vaksinimi ofrohet falas për të gjithë qytetarët dhe qytetarët, pavarësisht statusit të tyre të sigurimit.

A kryhet vaksinim me preferencë në rajone të caktuara?

Po. Për rajone të caktuara në të cilat incidentat janë veçanërisht të larta dhe njerëzit jetojnë në kushte strehimi shumë të ngjashura, Ministria e Shëndetësisë ka vënë në dispozicion sasi shtesë vaksinash për këto rajone. Në këto qytete dhe komuna zbatohen të ashtuquajturat "vaksinime të pjesshme të qytetit". Ju lutemi informohuni pranë autoriteteve lokale për procedurën e saktë.

A mund të vaksinohen gratë shtatzëna?

Gratë shtatzëna mund të kërkojnë konsultim me mjekun ose mjeken e tyre gjinekologe, për të qartësuar nëse duhet të vaksinohen ose jo.

A çon vaksinimi në infertilitet te gratë?

Përpara miratimit të vaksinave, ato testohen në mënyrë të thelluar. Nuk ka asnjë tregues që gratë të pësojnë humbjen e aftësisë riprodhuese për shkak të vaksinimit.

Në mediat sociale qarkullojnë informacione që vaksina kundër koronës mund të shkaktojë infertilitet, për shkak të ngjashmërisë midis proteinës "spike" të koronavirusit dhe proteinës "Syncytin-1" që është përgjegjëse për formimin e placentës. Si rezultat është arritur në përfundimin që: kur pas vaksinimit trupi i personit të vaksinuar krijon antitrupe kundër proteinës "spike" të koronavirusit, këto antitrupe sulmojnë gjithashtu edhe proteinën "Syncytin-1" dhe për rrjedhojë ndikojnë në formimin e placentës. Por meqë ngjashmëria midis këtyre dy proteinave është shumë minimale, reagimi i kryqëzuar i vaksinës së COVID-19 mund të përjashtohet.

A mund të shkaktojë vaksinimi kundër koronës sëmundje të tilla si kanceri?

Jo. Nuk ka asnjë tregues për diçka të tillë.

A është e vërtetë që brenda vaksinës ka mikroçipe?

Këto sugjerime janë legjenda konspirative dhe jo fakte reale. Ky supozim nuk është i vërtetë. Kërkimi shkencor i vaksinave kundër COVID-19 zhvillohet nga shkencëtarë dhe shkencëtarë të pavarur. Qëllimi i tyre është zhvillimi i një vaksine të mirë mbrojtëse kundër COVID-19.

Cilat sëmundje të mëparshme mund të pengojnë vaksinimin tim?

Deri më tani nuk ka kufizime të tjera të veçanta për shkak të sëmundjeve të mëparshme, përtej kufizimeve/këshillave të zakonshme si për vaksinat e tjera.

Ashtu si edhe në vaksinimet e tjera, nuk është e thënë që të sëmureni menjëherë rëndë, për shembull, mund të mos keni fare temperaturë mbi 38,5°C. Në rast alergjie ndaj përbërësve të vaksinave duhet që të përdoret një vaksinë tjetër, sipas rastit. Kjo është temë që trajtohet në diskutimin sqarues përpara vaksinimit.

Edhe në Gjermani janë shfaqur variante të mutacioneve të koronës. A mbrojnë vaksinat edhe kundër këtyre mutacioneve të virusit?

Efektiviteti ndaj mutacioneve dhe si rezultat i mbrojtjes ndaj tyre është objekt i kërkimit të vazhdueshëm. Deri më tani nuk ka asnjë tregues që vaksinat e miratuara nuk ofrojnë dot mbrojtje edhe në rastet e rënda për shkak të mutacioneve të reja.

Kur do të fitohet lufta me koronavirusin SARS-CoV-2?

Koronavirusi do të përcaktojë edhe për pak kohë mënyrën tonë të jetesës. Pasi të jetë vaksinuar një pjesë e konsiderueshme e popullsisë, ka të ngjarë të ndodhë që ne të jetojmë së bashku me virusin, ashtu siç mund të jetojmë me sëmundjet e tjera virale për të cilat ka tashmë vaksina.

A mundet që unë të vaksinohem me vaksinën kundër COVID-19 të AstraZeneca, edhe pse jam nën 60 vjeç?

Në parim, përdorimi i vaksinës së AstraZeneca nën kufirin e moshës 60 vjeç është gjithashtu diçka e mundur, pas sqarimit dhe konsultimit me mjekun dhe pranimin individual të rrezikut nga personi që do të vaksinohet.

A mundet që unë të vaksinohem me vaksinën kundër COVID-19 të Johnson&Johnson, edhe pse jam nën 60 vjeç?

Në parim, përdorimi i vaksinës së Johnson&Johnson nën kufirin e moshës 60 vjeç është gjithashtu diçka e mundur, pas sqarimit dhe konsultimit me mjekun dhe pranimin individual të rrezikut nga personi që do të vaksinohet.

Informohuni — ruani shëndetin!

Më shumë informacione: www.impfen.nrw